



Kuvendi i Komunës

Nr. 002/07/2020

Datë: 07.05.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12,2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr: 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr: 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22,1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 30.04.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për

bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2019 për shpenzim në vitin 2020

I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2019, për shpenzim në vitin 2020 në vlerë prej **95,039.25 €** si vijon:

- Shuma prej 15,874.79€ të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në kodin 42093 për projektin “**Ndertimi i E-kioskut në objektin e Komunës – Junik**”, në Programin Administrata dhe Personeli me kod 163, në nën Programin Administrata me kod 16320.
- Shuma prej 12,416.00€ të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në kodin 48470 për projektin “**Ndërtimi i aneksit në objektin e Komunës**”, në Programin Administrata dhe Personeli me kod 163, në nën Programin Administrata me kod 16320.
- Shuma 1,623.68€ të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në kodin 48467 për projektin “**Rregullimi i hapësirave rekreative rreth lumit Erenik**”, në Programin Planifikimi urban dhe mjedisi me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66405.
- Shuma prej **65,124.78 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në kodin 46030 për projektin **Bashkëfinancimi i projekteve**, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga pika I. e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

